



Ovaj projektat finansira
Evropska unija



M'Base

Projektet e mbështetura në
konkursin e dytë brenda
projektit OSHC-të në Mal të Zi -
**nga shërbimet themelore
deri tek formimi i politikave
në politikëbërjen M'BASE**



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG



VLADA CRNE GORE
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJE
POSREDOVANJE DRUŠTVA I MEDIJA

KANCELARIJA ZA
EVROPSKE INTEGRACIJE

The background of the entire page is a solid light blue color. Overlaid on this background are several thin, white, concentric circles that originate from the top-left corner and curve towards the right and bottom edges of the frame.

Kategoria I

Titulli i projektit: **Drejt buxhetimit lokal me përgjegjësi shoqërore**

Organizata udhëheqëse: **OJQ Forumi për Zhvillimin e Demokracisë**

Partnerët: OJQ „UDICA“

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në përmirësimin dhe zbatimin e parimeve të SIGMA-së të reformës së administratës publike, të cilat lidhen me menaxhimin e financave publike dhe përfshijnë menaxhimin transparent, të përgjegjshëm, strategjik dhe gjithëpërfshirës të parave publike.

Objektivi specifik i projektit është përmirësimi i cilësisë së praktikave buxhetore në komunat Bijelo Pole, Berane dhe Plevla në procesin e krijimit, shpenzimit dhe raportimit mbi buxhetin përmes monitorimit dhe dhënies së rekomandimeve nga organizatat e shoqërisë civile.

Është planifikuar që projekti të rezultojë në fuqizimin e kapaciteteve të organizatave joqeveritare në Bijelo Pole, Berane dhe Plevla, prodhimin e video spotit dhe publikimeve *Si planifikohen dhe shpenzohen buxhetet komunale?* dhe *Buxheti Qytetar për vitin 2022 për komunat Bijelo Pole, Berane dhe Plevla*.

Aktivitetet e projektit përfshijnë hulumtimin cilësorë të përgatitjes dhe zbatimit të buxheteve të komunave Bijelo Polje, Berane dhe Pljevlja në periudhën 2015-2020; hulumtimin e cilësisë së procesit buxhetor bazuar në monitorimin gjatë kalendarit buxhetor për vitin 2021 (qershor - dhjetor 2021) për komunat Bijelo Pole, Berane dhe Plevla; hartimin e Buxhetit Qytetar për vitin 2022 për komunat Bijelo Pole, Berane dhe Plevla; programin e *Shkollës së Financave Publike* për përfaqësuesit e OJQ-ve nga Bijelo Pole, Berane dhe Plevla; prodhimin e video spotit *Merrni pjesë - pyet ku janë paratë?*; dhe organizimin e forumeve publike në komunat ku realizohet projekti.

Projekti zgjat 11 muaj, dhe buxheti total i miratuar është 14,722.09 EUR.



Titulli i projektit: **Sheila – Historia e një fati tragjik që mund të ishte parandaluar**

Organizata udhëheqëse: **OJQ Harlequin**

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në uljen e nivelit të dhunës në Mal të Zi, duke rritur ndërgjegjjen e autoriteteve kompetente për nevojën e bashkëpunimit dhe efikasitetit të mekanizmave për parandalimin e dhunës ndaj grave, bashkëmoshatarëve, dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës në shoqëri.

Objektivi specifik është rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit të parandalimit të dhunës në Mal të Zi, përmes krijimit të filmit dokumentar të shkurtër që do të informoi institucionet përkatëse dhe qytetarët me pasojat e sistemit joefikas, të vonuar dhe të papërgjegjshëm të parandalimit të dhunës.

Projekti do të *rezultojë* me dokumentar të shkurtër për Sheilën, vajzën e vrarë tragjikisht, viktimën e dhunës. Gjithashtu, filmi pritet të ndikojë në sensibilizimin e popullatës së përgjithshme dhe vendimmarrësve për pasojat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe nevojën për efikasitet më të madh dhe bashkëpunim më të mirë të institucioneve në fushën e parandalimit të dhunës.

Aktivitetet e projektit fokusohen në prodhimin e filmit dokumentar; fushatën për ngritjen e nivelit të ndërgjegjësimi të përfaqësuesve të institucioneve përkatëse dhe publikut të gjerë për nevojën për parandalim më efikas dhe efektiv të dhunës dhe pasojat e veprimeve të parakohshme dhe joadekuate të autoriteteve kompetente.

Projekti zgjat 6 muaj, dhe buxheti total i miratuar është 19,990.10 EUR.

Titulli i projektit: **Shoqëria e fortë civile në shërbim të qytetarëve aktiv**

Organizata udhëheqëse: **OJQ Qendra për Tranzicion Demokratik (CDT)**

Bashkëpunëtorët: Kryeqyteti Podgorica

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të forcojë kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile për të zbatuar modele inovative të pjesëmarrjes qytetare.

Më konkretisht, projekti synon të sigurojë mekanizma për pushtetin lokal për përfshirje të pavarur, të paanshme dhe funksionale të qytetarëve në procesin e politikëbërjes, si dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe subjekteve politikë për modelet inovative të pjesëmarrjes qytetare në politikëbërje.

Rezultatet e pritura janë: bashkëpunimi i krijuar me kryeqytetin si bazë për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta; kapacitetet e ngritura të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të Kuvendit të Kryeqytetit përmes programit të hartuar posaçërisht; krijimi i një temë të dukshme për publikun përmes fushatës në mediat tradicionale, elektronike dhe sociale.

Aktivitetet kryesore përfshijnë: dy kurrikula të zhvilluara për punëtori/trajnime interaktive; organizimi i një punëtorie për përfaqësuesit e Kuvendit të Kryeqytetit; trajnimi i pesë organizatave të shoqërisë civile për Asamblenë Qytetare si instrument inovativ i demokracisë deliberative; trajnimi i 10 facilitatorëve për zbatimin e Kuvendit të Qytetarëve; prezantimin e Kuvendit të Qytetarëve të Kryeqytetit para publikut; informimi i 10.000 qytetarëve për aktivitetet e projektit përmes njoftimeve në media, njoftimeve në rrjetet sociale dhe komunikimit të drejtpërdrejtë.

Projekti zgjat 7 muaj dhe buxheti total i miratuar është 17,480.94 EUR.



*Centar za
feminističku
kulturu*

*Titulli i projektit: **BRIGADA.ME - platformë dixhitale për kulturën evropiane***

*Organizata udhëheqëse: **SHJQ Art 365***

Partnerët: OJQ NOVA - Qendra për Kulturë Feministe

Objektivi i përgjithshëm i projektit është forcimi i sistemit kulturor në Mal të Zi për të marrë një rol më domethënës në procesin e integritimit të Malit të Zi në BE dhe emancipimin qytetar të shoqërisë malazeze.

Më konkretisht, projekti fokusohet në rritjen e kapaciteteve njohëse, kritike dhe artistike të 20 punonjësve të rinj të kulturës për aktivitete të angazhuara shoqërore dhe bashkëkohore në fushën e kulturës në gjurmët e politikave dhe praktikave kulturore në BE, por edhe për të rritur ndërgjegjësimin e aktorëve të tjerë kulturorë dhe politikë për rëndësinë e sektorit kulturorë në procesin e integritimit të Malit të Zi në BE dhe emancipimin civil të shoqërisë malazeze.

Rezultatet e pritura janë: kapacitetet e fuqizura të 20 punëtorëve të rinj të kulturës për ndërhyrje në fushën e kulturës; njohuritë e avancuara të rreth 300 artistëve të rinj dhe ekspertëve të kulturës nëpërmjet monitorimit të klasës online të kulturës evropiane, mbi ndikimin e mundshëm të kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik dhe rolin e praktikave të artit dixhital në këtë kontekst; rritja e dukshmërisë dhe kuptimit të rëndësisë së kulturës; platforma e themeluar dixhitale “Brigada.me”.

Aktivitetet kryesore janë realizimi i rezidencës artistike dhjetë ditore në Shavnik, e cila do t’u mundësojë artistëve të rinj dhe punëtorëve të kulturës të lidhen në baza të ndryshme (gjenerative, artistike, etj.); prodhimi i 20 veprave të artit që përcjellin në mënyrë virale dhe sugjестive mesazhin se çfarë lloj kulture është aktualisht në Mal të Zi dhe çfarë mund të jetë ajo (përsa i përket ndikimit të saj në emancipimin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik); organizimi i gjashtë leksioneve online mbi politikën dhe praktikën kulturore evropiane (klasë online e kulturës evropiane); puna në platformën dixhitale “Brigada.me” si dokument mbi projektin dhe burim i ndikimit të mëtejshëm të ideve të projektit, por edhe si faktor për lidhjen e mëtejshme të artistëve të rinj dhe ekspertëve të kulturës rreth idesë së kulturës që ndikon në shoqëri dhe zhvillimin ekonomik duke përdorur praktikën e artit bashkëkohor për të riprodhuar atë vlerë.

Projekti zgjat 7 muaj, dhe buxheti total i miratuar është 19,102.38 EUR.

Titulli i projektit: **STOP seksizmit në Mal të Zi**

Organizata udhëheqëse: **Instituti për Studime Ligjore IPLS**

Objekti i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Mal të Zi.

Objekti specifik është forcimi i rolit të organizatave të shoqërisë civile në eliminimin e stereotipeve gjinore dhe luftimin e seksizmit në Mal të Zi.

Rezultatet e pritura të projektit janë: analiza e kornizës legjislative dhe definimi i propozimeve për ndryshime në kuadrin ligjor që përcaktojnë dhe kriminalizojnë gjuhën e urrejtjes seksiste; udhëzime të zhvilluara për eliminimin e seksizmit në punën e institucionit të Mbrojtësit të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

Aktivitetet kryesore përfshijnë: takime me përfaqësues të institucioneve të përfshira në zbatimin e projektit; përcaktimi i metodologjisë së hulumtimit; kryerja e analizave ligjore; prezantimin e analizave dhe rekomandimeve për ndryshime në kornizën ligjore në takimet e punës; krijimin e një grupi punues për zhvillimin e udhëzimeve për eliminimin e seksizmit në punën e Institucionit të Ombudsmanit; organizimi i dy sesioneve njëditore me anëtarët e grupit punues; prezantimi i draft udhëzimeve për punonjësit e Institucionit të Ombudsmanit; publikimi i udhëzimeve të miratuara nga Institucioni i Ombudsmanit.

Projekti zgjat 6 muaj, dhe buxheti total i miratuar është 17,304.00 EUR.



Titulli i projektit: Rinia aktive për vlerat evropiane

Organizata udhëheqëse: Qendra Sociologjike e Malit të Zi SOCEN

Partnerët: OJQ Ndërveprimi (Interakcija)

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të forcojë kapacitetet e OJQ-ve rinore dhe të stimulojë pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave publike dhe vendimmarrëse.

Objektivi specifik nënkupton stimulimin e aktivizmit social dhe përgjegjësisë sociale të të rinjve dhe të rrisë pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje dhe politikëbërje, duke forcuar kapacitetin e organizatave studentore për të shkruar propozime për politika publike dhe për të avokuar për ndryshime politikash, duke rrjetëzuar nxënësit dhe studentët në Mal të Zi, si dhe përmirësimin e njohurive të tyre për vlerat dhe aktivizmin rinor në BE.

Rezultatet e pritura janë: rrjetëzimi i organizatave rinore në Mal të Zi dhe fuqizimi i kapaciteteve të tyre në fushën e shkrimit të propozimeve publike praktike të politikave dhe avokimit për ndryshime në politikat publike; përmirësimi i njohurive të të rinjve dhe shkëmbimi i përvojës për zhvillimin e aktivizmit dhe kulturës së pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse; rritja e ndërgjegjësimit të të rinjve për nevojën për të krijuar politikën rinore në Mal të Zi dhe pjesëmarrjen aktive në proceset vendimmarrëse në nivel lokal dhe kombëtar.

Aktivitetet e planifikuara të projektit janë organizimi i 6 takimeve me organizatat rinore për të hartuar problemet kryesore me të cilat përballen këto organizata në sigurimin e qëndrueshmërisë dhe punës efikase; 3 seminare për përfaqësuesit e organizatave rinore për të shkruar politika praktike publike dhe për të avokuar propozimet e tyre në skenën publike; ofrimi i mbështetjes mentoruese për përfaqësuesit e organizatave rinore gjatë përgatitjes së propozimeve praktike të politikave publike në fushën e interesit më të madh për funksionimin e tyre; publikimi i të paktën 3 analizave (policy brief) nga organizatat rinore; 3 punëtori interaktive mbi aktivizmin rinor bazuar në vlerat e BE-së në shkollat e mesme; tryezë e rrumbullakët mbi temë “*Antifashizmi si ilaç - rinia aktive për vlerat evropiane*”; zhvillimi i një fushate mediatike; dhe një konferencë kombëtare ku do të prezantohen rezultatet e punës.

Projekti zgjat 12 muaj, dhe buxheti total i miratuar është 18,117.7 EUR.



Titulli i projektit: Muzikë për të gjithë! - Forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve në fushën e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në Mal të Zi

Organizata udhëheqëse: OJQ Organizata për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorëve të Muzikës të Malit të Zi - PAM CG

Partnerët: OJQ STIVI MUSIC

Bashkëpunëtorët: QKI "Budo Tomović" Podgoricë

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të forcojë organizatat e shoqërisë civile (OSHC) për pjesëmarrje aktive në procesin e integritimit në BE të Malit të Zi.

Objektivat specifike janë ngritja e ndërgjegjësimit të grupeve të synuara për rëndësinë e *acquis communautaire* në fushën e Negocimit të Kapitullit 7 (ligji i pronësisë intelektuale), forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të arritur mbrojtjen kolektive të autorëve dhe interpretuesve të muzikës në Mal të Zi, dhe forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zhvillimin e industrive kreative kulturore në Mal të Zi.

Projekti pritet të *rezultojë* në nivel më të lartë informacioni dhe edukimi të grupeve të synuara për mbrojtjen e të drejtës së autorëve në Mal të Zi dhe ndërkombëtarisht; kapaciteteve të fuqizuara të sektorit civil për monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të autorëve muzikorë në përputhje me detyrimet e procesit të negociatave me BE-në; promovimi potencial i industrive kreative kulturore dhe krijuese përmes fushatave mediatike dhe organizimit të eventeve inovative muzikore.

Aktivitetet e planifikuara përfshijnë: punëtori edukative për autorët dhe muzikantët e rinj me temën e ushtrimit të të drejtave kolektive; seminar për përdoruesit e veprave muzikore me temën e përdorimit publik të veprave të të drejtave të autorit; krijimi i fletushkave informative; prezantimi i projektit dhe aktiviteteve kryesore; një konferencë njëditore për zbatimin e zgjidhjeve ligjore në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale dhe *acquis communautaire* të BE-së; organizimi i një ngjarje kulturore kreative inovative; një fushatë për të promovuar aktivitetet e projektit për të informuar publikun për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtës së autorit.

Projekti zgjat 10 muaj dhe buxheti total i miratuar është 13,156.90 EUR.



*Titulli i projektit: **Së bashku për një Vezishnicë më të pastër***

*Organizata udhëheqëse: **OJQ Të ringjallet fshati – Plevla (Da zaživi selo – Pljevlja)***

Partnerët: OJQ Legalis

Bashkëpunëtorët: Sekretariati për Çështje Banesore dhe Komunale, Trafik dhe Ujë i Komunës së Pevlës, Klubi i Peshkimit Sportiv “Liplen”, OJQ Qendra Informative Plevla

Objektivi i përgjithshëm i projektit është mbrojtja e mjedisit duke përmirësuar cilësinë e ujit të lumit Vezishnica.

Objektivat specifike janë menaxhimi i duhur i ujërave të zeza komunale; ngritja e nivelit të vetëdijes së popullatës për menaxhimin e duhur të ujërave të zeza komunale; përmirësimi i cilësisë së ujit të lumenjve Vezishnica dhe Qehotina.

Rezultatet e planifikuara të projektit janë: iniciativa për zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza komunale në lumin Vezishnica; realizimi i një dokumentari mbi çështjet ekologjike të lumit Vezishnica; anketimi i 100 amvisërive në vendbanimet përgjatë lumit Vezishnica për problemin e ujërave të zeza komunale; intensifikimi i diskutimit për temën e ujërave të zeza komunale në lumin Vezishnica me subjektet përkatëse; realizimi i fushatës informuese dhe edukative për problemet dhe zgjidhjet lidhur me ujërat e zeza komunale; aktivizmi i fuqizuar të rinjve vendas rreth çështjeve mjedisore.

Aktivitetet përfshijnë: zhvillimin e Kadastrës së shkarkimeve ilegale të ujërave të zeza komunale në lumin Vezishnica; përgatitja e broshurës edukative për problemin dhe zgjidhjet në trajtimin e ujërave të zeza komunale në zonat ku nuk ka kolektor të qytetit; anketimi i 100 amvisërive në vendbanimet përgjatë lumit Vezishnica për problemin e ujërave të zeza komunale, përpunimi i anketimit dhe publikimi i rezultateve të anketës përmes mediave; xhirimi dhe transmetimi i një dokumentari mbi çështjet mjedisore të lumit Vezishnica, me theks në ujërat e zeza komunale ilegale; organizimi i dy ligjëratave / tryezave të rrumbullakëta për problemin e ujërave të zeza komunale në lumin Vezishnica me subjektet përkatëse (qeveria lokale, inspeksioni komunal dhe ndërtimor, përfaqësues të komuniteteve lokale, shkollat në Oxhak dhe Borovicë, peshkatarët, piknikerët); organizimi i aksionit për pastrimin e zonës së piknikut në Dokun e Peros i cili gjendet në bregun e lumit Vezishnica dhe në afërsi të vendbanimit Oxhak dhe shkollës fillore “Mihailo Zhugiq” në Oxhak.

Projekti zgjat 7 muaj dhe buxheti total i miratuar është 13,606.84 EUR.

*Titulli i projektit: **Krijimi gjithëpërfshirës i politikave dhe shërbimeve publike lokale***
*Organizata udhëheqëse: **OJQ Prindërit (Roditelj)***

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është të përmirësojë mënyrën se si funksionojnë shërbimet kombëtare sociale, arsimore dhe të mbrojtjes së fëmijëve, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia në ofrimin e shërbimeve bazë për fëmijët dhe familjet e tyre në përgjigjen afatgjatë ndaj pandemisë COVID-19.

Objektivat specifike të projektit përfshijnë fuqizimin e qytetarëve, prindërve, shoqatave lokale të prindërve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile për pjesëmarrje aktive në zhvillimin e politikave publike, avokimit dhe shërbimeve të pushtetit lokal; përmirësimi i të kuptuarit të kompetencave dhe punës së institucioneve të linjës për ofrimin e shërbimeve cilësore që përfshijnë temat kryesore të prindërimit.

Rezultatet e pritura janë: përmirësimi i aksesit të prindërve në institucionet publike lokale dhe forcimi i kanaleve të komunikimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve/sectorit civil; zhvillimi i përmbajtjes së re (dixhitale) për të promovuar tema të rëndësishme për shoqatat lokale të prindërve, në komunikimin me institucionet dhe për të marrë pjesë në hartimin e politikave dhe avokimin.

Projekti është planifikuar përmes *aktiviteteve*, ku kryesoret janë: organizimi i ditës së hapur “Prindërit pyesin”; zhvillimi dhe kryerja e një pyetësori online për shërbimet më efektive në nivel lokal dhe shpërblimi i shërbimit më të mirë; zhvillimi dhe kryerja e sondazhit për shërbimet me prioritet më të lartë që duhet të digjitalizohen dhe hartimin e një plani veprimi; prodhimi dhe transmetimi i përmbajtjes dixhitale me qëllim të promovimit në mënyrë gjithëpërfshirëse të formësimit të politikave dhe shërbimeve publike lokale; përmirësimi i kapaciteteve të shërbimeve kombëtare dhe vendore për mbrojtjen sociale, arsimore dhe të fëmijëve, organizatave të shoqërisë civile, shoqatave lokale të prindërve dhe qytetarëve për politikëbërje dhe avokim me pjesëmarrje.

Projekti zgjat 6 muaj dhe buxheti total i miratuar është 19,231.13 EUR.



Titulli i projektit: **SHOH NJË ARTIST! NDIEJ NJË SHOQËRI MË TË MIRË**

Organizata udhëheqëse: **Shoqata e Artistëve të Malit të Zi**

Bashkëpunëtorët: Fakulteti i Arteve, Universiteti i Malit të Zi, Institucioni Publik Qendra për Aktivitete Kulturore Bijelo Pole, Institucioni Publik Muzeu dhe Galeria e Tivatit

Objektivi kryesor i projektit është përmirësimi i statusit social të artistëve të rinj.

Objektivat specifike janë të forcojnë dukshmërinë dhe praninë e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në procesin e vendimmarrjes dhe metodat e veprimit në kulturë; realizimi i bashkëpunimit ndërmjet: artistëve të rinj - OSHC - përfitues të projektit; stimulimi i proceseve krijuese dhe prodhimi i ri vizual; forcimi i rolit të organizatës profesionale.

Rezultatet e pritura janë: definimi, forcimi dhe promovimi i kapaciteteve të artistëve të rinj; nevojat e sektorit dhe mënyrat për adresimin e këtyre nevojave të profilizuara; realizimi i prodhimit të artistike inovative.

Aktivitetet kryesore përfshijnë edukimin, promovimin dhe mbështetjen e artistëve të rinj; organizimi i konferencës “Kultura e pavarur, këtu dhe tani”; prodhimi i veprave inovative të artit bashkëkohor; prezantimi i veprave të artit bashkëkohor dhe autorëve të tyre në hapësirë publike, galeri dhe dixhitale; mbledhjen e të dhënave, sublimimin e përvojave dhe publikimin e tyre.

Projekti zgjat 6 muaj dhe buxheti total i miratuar është 18,696.48 EUR.

The background of the entire page is a solid purple color. Overlaid on this background are several thin, white, concentric circles that originate from the top-left corner and curve towards the right side of the page, creating a sense of depth and movement.

Kategoria II

Titulli i projektit: **Kapitulli 23 në komunitetin tim**

Organizata udhëheqëse: **Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare (CRNVO)**

Partnerët: Qendra për Zhvillim Rural - Petnjica

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin e integrimit evropian të Malit të Zi.

Objektivi specifik është rritja e pjesëmarrjes së organizatave lokale të shoqërisë civile (OSHC), mediave dhe qytetarëve në monitorimin e procesit të integrimit evropian në fushën e sundimit të ligjit (Kapitulli 23).

Rezultatet e pritura janë: vendosja e monitorimit të pavarur të zbatimit të reformave në Kapitullin 23; kapacitetet e forcuara të OSHC-ve lokale për të kuptuar dhe monitoruar reformat në fushën e sundimit të ligjit (Kapitulli 23); edukimi i përmirësuar i gazetarëve për përmbajtjen e Kapitullit 23 dhe raportimi adekuat për çështjet e sundimit të ligjit; mirëkuptimi i përmirësuar të qytetarëve për përfitimet e reformave të sundimit të ligjit (Kapitulli 23).

Aktivitetet kryesore përfshijnë: krijimin e ekipit ekspert për të përgatitur analizë për zbatimin e reformave në Kapitullin 23; prodhimi i analizës; organizimi i tre trajnimeve për OSHC-të lokale në fushën e monitorimit të Kapitullit 23; mentorimi i OSHC-ve lokale për të shkruar raporte të shkurtra mbi reformat në Kapitullin 23; organizimi i tre trajnimeve për gazetarët në fushën e monitorimit të Kapitullit 23; realizimi i tre raporteve televizive (artikuj gazetash) mbi reformat në Kapitullin 23; prodhimi i një videoje informative për qytetarët në Kapitullin 23; organizimi i nëntë forumeve për qytetarët mbi procesin e anëtarësimit.

Projekti zgjat 12 muaj dhe buxheti total i miratuar është 40,289.52 EUR.



Titulli i projektit: **Media për shoqëri të përgjegjshme**

Organizata udhëheqëse: **Shoqata e Mediave të Evropës Juglindore (MAJE)**

Partnerët: Instituti për Media të Malit të Zi (IMCG), Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Malit të Zi (DPNCG)

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të mbrojë dhe promovojë të drejtat e njeriut të gazetarëve në Mal të Zi, por edhe grupeve të marginalizuara, kryesisht grave, personave LGBT dhe romëve, të cilët janë objekt i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në diskursin publik të krijuar nga media.

Më *konkretisht*, projekti fokusohet në uljen e dezinformimit të të rinjve dhe sigurimin e përmbajtjes gazetareske të saktë, objektive dhe profesionale nëpërmjet përdorimit të teknologjive inovative.

Rezultatet e planifikuara janë: rritja e ndjeshmërisë në hapësirën publike në pjesën që lidhet me gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit, në radhë të parë ndaj grave, popullatës LGBT dhe romëve; përmirësimi i parakushteve për punën e gazetarëve në Mal të Zi me theks në sigurinë psiko-fizike; përmirësimi i informimit të të rinjve me përmbajtje mediatike të saktë, objektive dhe profesionale.

Aktivitetet kryesore përfshijnë: analizën e diskursit publik në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit me rekomandime për përmirësim, me prezantim shoqërues në media dhe publikim në rrjetet sociale; tre panele për identifikimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në hapësirën publike dhe trajnimin e gazetarëve në rajonin verior, jugor dhe qendror të Malit të Zi; kryerja e fushatës edukative përmes mediave tradicionale dhe rrjeteve sociale për të reduktuar gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit; analiza e veprimeve të autoriteteve kompetente në rastet e dhunës ndaj anëtarëve të komunitetit mediatik me rekomandime për përmirësim dhe iniciativa për përcaktimin e përgjegjësisë, me prezantim shoqërues; tri drama psikologjike dyditore për gazetarë dhe punonjës të tjerë të mediave; ofrimi i ndihmës psikologjike individuale për gazetarët; dy analiza të konsumit të përmbajtjeve mediatike nga të rinjtë, me prezantim shoqërues; një trajnim dy-ditor për gazetarët për prodhimin e përmbajtjes inovative mediatike dhe shpërndarjen përmes kanaleve të komunikimit dixhital; mentorimi në zhvillimin dhe promovimin e përmbajtjeve inovative mediatike për të rinjtë.

Projekti zgjat 12 muaj dhe buxheti total i miratuar është 47,237.86 EUR.

Titulli i projektit: **Rinia në fokusin e shoqërisë**
Organizata udhëheqëse: **Rrjeti Rinor i Malit të Zi**
Bashkëpunëtor: Drejtoria për Sport dhe Rini

Objekti i përgjithshëm i projektit është pjesëmarrja më e madhe e të rinjve në proceset vendimmarrëse duke ndërtuar ndërgjegjësimin social për nevojën e pjesëmarrjes së të rinjve, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar, duke inkurajuar dialogun ndërmjet të rinjve nga të gjithë sektorët dhe aktorëve përkatës.

Objektivat specifike fokusohen në fuqizimin dhe informimin e të rinjve për rëndësinë e veprimit aktiv dhe mekanizmave për pjesëmarrje në demokratizimin e shoqërisë; edukimin e të rinjve për arsimimin politik dhe qytetar dhe formimin e liderëve të rinj të gatshëm për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit të tyre; forcimi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave anëtare të Rrjetit dhe bashkëpunimi me institucionet duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e politikave rinore.

Rezultatet e pritura të projektit janë: rritja e informacionit të përgjithshëm të të rinjve në Mal të Zi për rëndësinë e politikave rinore dhe mekanizmave të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse; ndërgjegjësimi i përmirësuar për rëndësinë e funksionimit të shërbimeve rinore dhe rrjetëzimit të të rinjve përmes bashkëpunimit dhe dialogut; të edukuar së paku 240 të rinj nga 12 komuna malazeze në temën e politikës rinore, punës rinore dhe aktivizmit rinor; i krijuar Parlamenti Rinor në Mal të Zi.

Aktivitetet e planifikuara të projektit përfshijnë: zhvillimin e materialit edukativ për të rinjtë; krijimin e *Fjalorit të Politikave Rinore*; realizimin e klipeve informative dhe edukative mbi pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse; vizita në shërbimet rinore në 12 komuna; seminare në shërbimet rinore me temën e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse; formimin e ekipit për organizimin e Parlamentit të parë Rinor në Mal të Zi; hulumtimin e qëndrimeve të të rinjve dhe delegimi i temave; organizimin e seancave të Parlamentit Rinor në të cilin do të marrin pjesë në mënyra të ndryshme të paktën 100 të rinj nga i gjithë Mali i Zi; organizimi i Akademisë Rinore gjashtëditore; fushatën mediatike dhe fushatat në mediave sociale.

Projekti zgjat 9 muaj dhe buxheti total i miratuar është 36,223.2 EUR.

institut alternativa

Titulli i projektit: **As klient, as shef! - Për integritetin e punësimit në sektorin publik**

Organizata drejtuese: **Instituti Alternativa (IA)**

Bashkëpunëtor: Ministria e Administratës Publike, Shoqërisë Dixhitale dhe Medias

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit duke avokuar për integritetin e punësimit në sektorin publik.

Objektivi specifik është të përcaktojë dhe promovojë përgjigje efektive ndaj praktikave korruptive dhe ndikimit të papërshtatshëm politik në punësimin në sektorin publik.

Projekti pritet të *rezultojë* me rreziqet e përcaktuara për praktikën korruptive dhe ndikimit të papërshtatshëm politik në punësimin në sektorin publik nga sektori civil, si dhe dialogut të bazuar në prova për reagimin efektiv ndaj praktikave korruptive dhe ndikimit të papërshtatshëm politik në punësimin në sektorin publik.

Aktivitetet fokusohen në krijimin e një harte ndërvepruese të rrezikut për punësimin në sektorin publik; tre fokus grupe mbi praktikën korruptive dhe ndikimin e papërshtatshëm politik në punësimin në sektorin publik; seminar për vënien në dukje të praktikave korruptive në punësimin në sektorin publik; përcaktimin e rekomandimeve për aplikim më të mirë të mekanizmave kundër korrupsionit në punësimin në sektorin publik; fushata avokuese “*As klient, as shef*”; forum dyditor mbi korrupsionin dhe klientelizmin politik në sektorin publik.

Projekti zgjat 10 muaj dhe buxheti total i miratuar është 49664,54 EUR.



Titulli i projektit: E drejta juaj është e garantuar: për mbrojtje më efektive të interesave ekonomike të konsumatorëve me sektor të fuqizuar civil

Organizata udhëheqëse: Qendra për Mbrojtjen e Konsumatorit (CEZAP)

Partnerë: OJQ SPONA Berane

Bashkëpunëtor: Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të forcojë kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile dhe rolin e tyre në monitorimin dhe përmirësimin e politikave kombëtare për mbrojtjen e konsumatorëve në përputhje me *acquis* të BE-së.

Më konkretisht, projekti synon të realizojë të drejtat e konsumatorëve dhe interesat e tyre ekonomike nëpërmjet krijimit të mekanizmit për monitorimin e punës së organeve inspektuese dhe nxitjen e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës.

Rezultatet e planifikuara të projektit janë kapacitetet e OSHC-ve të fuqizuara në fushën e mbikëqyrjes e punës së organeve inspektuese, si dhe për rrjetëzimin dhe ofrimin e ndihmës juridike për konsumatorët; përmirësimi i kornizës institucionale dhe legjislative për mbrojtjen e konsumatorit në fushën e pajtueshmërisë dhe garancive dhe fuqizimi i mekanizmit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës; ndërgjegjëja e rritur e palëve të interesuara dhe konsumatorëve për parimet dhe përfitimet e mbrojtjes jashtë gjykatës në përputhje me standardet dhe praktikën e BE-së në lidhje me realizimin e të drejtave të garantuara me ligj.

Aktivitetet kryesore janë takimet me anëtarët e Rrjetit për Mbrojtjen e Konsumatorit; trajnime të avancuara për OSHC-të mbi metodologjinë e kërkimit dhe avokimit; ofrimi i ndihmës falas; monitorimin e veprimeve të organeve inspektuese për ankesat dhe hartimin e raportit “*Kompensimi në rastet e moskonformitetit të produkteve – sfidat kryesore*”; analiza e kornizës legjislative (komentet për Kodin e Procedurës Civile); nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve jashtë Gjykatës; zhvillimi i ueb platformës për fillimin e procedurave të arbitrazhit online; tryezë e rumbullakët për ushtrimin e të drejtave të bazuara në pajtueshmëri, garanci dhe ekspertizë; konferencë kombëtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës; prodhimi dhe shpërndarja e broshurave informative; karvani informativ për konsumatorët në komunat veriore, duke zhvilluar një fushatë mediatike për publikun e gjerë.

Projekti zgjat 12 muaj dhe buxheti total i miratuar është 36,688.60 EUR.

PRONA

Titulli i projektit: Karvani i shkencës drejt BE-së - Përmirësimi i shkrim-leximit shkencor të të rinjve në Mal të Zi

Organizata udhëheqëse: PRONA Fondacioni për Promovimin e Shkencës

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në promovimin e shkencës, përhapjen e kulturës shkencore dhe shkrim-leximit shkencor, si dhe vlerën e shkencës për të arritur qëllimet evropiane dhe globale të zhvillimit të qëndrueshëm.

Objektivat specifike janë kontributi në arritjen e standardeve të larta të shkrim-leximit shkencor, promovimit dhe popullarizimit të shkencës dhe karrierës shkencore tek të rinjtë; përmirësimi i procesit të zbatimit të programeve kombëtare në fushën e shkencës dhe inovacionit, të parashikuara në Kapitullin 25 të Negocimit (Shkenca dhe Kërkimi); dhe forcimin e kompetencave të mësuesve për qasjen shumëdisiplinore ndaj të mësuarit që çon në zotërimin e aftësive të nevojshme moderne (STEM), si qasje arsimore inovative për zhvillimin e qëndrueshëm.

Rezultatet e pritura janë: përmirësimi i shkrim-leximit shkencor dhe promovimi i rëndësisë së shkencës dhe perspektivat e karrierës në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës (STEM) në të paktën 1000 të rinj nga 10 komuna në të tre rajonet e Malit të Zi; rritja e shkallës më të madhe të zbatimit të programeve kombëtare në fushën e shkencës dhe inovacionit, të parashikuara në kapitullin 25; përmirësimi i të kuptuarit të aplikimit të konceptit STEM të arsimit nga të paktën 30 mësues nga 10 komuna të Malit të Zi; e krijuar qendra informacioni për orientimin profesional dhe mbështetjen e të rinjve në zgjedhjen e karrierës në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë (STEM), por edhe e zhvilluar një fushatë me qëllim promovimin e shkencës dhe kërkimit shkencor si koncept i zhvillimit të qëndrueshëm.

Fokusi i *aktiviteteve* është organizimi i festivalit shkencor udhëtues “Karvani i shkencës drejt BE-së” në 10 komuna malazeze nga të tre rajonet; monitorimi i zbatimit të kriterëve përfundimtarë për *acquis communautaire* në lidhje me Kapitullin 25 të Negocimit; organizimi i tre punëtorive dy-ditore (në rajonin Jugor, Verior dhe Qendror të Malit të Zi) për mësuesit mbi qasjen multidisiplinare ndaj të mësuarit (STEM) e cila është e përfaqësuar gjerësisht në shkollat evropiane, me qëllim të rritjes së interesit dhe aftësisë së të rinjve për studimin e fushave shkencore përmes teknologjisë dhe inxhinierisë; promovimi i qëllimeve dhe aktiviteteve të projektit.

Projekti zgjat 10 muaj dhe buxheti total i miratuar është 46,592.05 EUR.

Titulli i projektit: Forumi për të drejtat e PAK

Organizata udhëheqëse: Shoqata e të rinjve me aftësi të kufizuara të Malit të Zi (UMHCC)

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në rritjen e nivelit të pjesëmarrjes së organizatave të personave me aftësi të kufizuara (OPAK) në proceset vendimmarrëse dhe politikëbërëse në lidhje me integrimin evropian në Mal të Zi.

Objektivat specifike janë: përmirësimi i kapacitetit të të paktën 10 OPAK për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (PAK) në nivel kombëtar dhe lokal në përputhje me praktikatat e BE-së; ngritja e nivelit të njohurive të politikëbërësve dhe vendimmarrësve në fushën e integritimit evropian për PAK dhe të drejtat e tyre; niveli i përmirësuar i njohurive të PAK mbi përvojat dhe praktikatat evropiane në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të PAK dhe rrjetëzimi me PAK të Europës.

Projekti do të *rezultojë* me kapacite të fuqizuara prej të paktën 10 PAK për të avokuar publikisht për të drejtat e PAK në nivel kombëtar dhe lokal në përputhje me praktikatat e BE-së; i iniciuar harmonizimi i politikave kombëtare të Malit të Zi në fushën e të drejtave të PAK dhe OPAK me rregulloret e BE-së; bashkëpunimi i OPAK në nivel kombëtar dhe lokal në Mal të Zi me OPAK nga BE-ja me qëllim shkëmbimin e njohurive dhe përvojave.

Aktivitetet e planifikuara përfshijnë: trajnime për organizatat PAK dhe PAK për të drejtat e njeriut; trajnime për OPAK dhe PAK mbi avokimin publik për të drejtat e PAK në nivel kombëtar dhe lokal në përputhje me praktikatat e BE-së; ndihmë juridike falas për PAK dhe OPAK; Shkolla e të Drejtave të Njeriut PAK për Përfaqësuesit e Strukturave Negociatore (me fokus në kapitujt 5, 18, 19, 23, 24 dhe 28); avokimi për përcaktimin e statusit përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara; forumi për shkëmbimin e përvojave të organizatave malazeze dhe evropiane të PAK; fushatë mediatike.

Projekti zgjat 12 muaj dhe buxheti total i miratuar është 53,856.02 EUR.



Titulli i projektit: Mbështetje për qasjen participative në zhvillimin e Planit Zhvillimor Strategjik të Komunës së Nikshiqit

Organizata udhëheqëse: OJQ Shoqata e Ekologëve të Rinj Nikshiq

Partnerët: OJQ Rrugët e paraardhësve (Putevima predaka), OJQ Agro eko Lukovo

Bashkëpunëtorët: Komuna e Nikshiqit, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i politikave dhe planifikimit strategjik në fushën e mbrojtjes së mjedisit në komunën e Nikshiqit.

Objektivi specifik është hartimi i plan zhvillimit strategjik për komunën e Nikshiqit në fushën prioritare “Mbrojtja e mjedisit” duke respektuar parimet participative dhe transparente.

Rezultatet e pritshme janë: formimi i Grupit Lokal të Partneritetit (LPG) për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik në fushën e mjedisit; i realizuar procesi gjithëpërfshirës konsultimi dhe dialogu me publikun profesional dhe popullatën lokale të Komunës së Nikshiqit; i hartuar aneksi i Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit.

Projekti planifikon **aktivitete** që përfshijnë: trajnimin për LPG dhe OJQ-të për planifikimin strategjik, monitorimin e politikave dhe raportimin; raportimi i publikut për punën e GLN-së përmes mediave lokale; trajnime për përfaqësuesit e komuniteteve lokale; takime konsultative me përfaqësuesit të pesë komuniteteve më të mëdha lokale; realizimi i një fushate dixhitale; zhvillimi dhe shpërndarja e pyetësorëve online për qytetarët mbi prioritetet mjedisore për planin e ri të zhvillimit strategjik; takime tematike; konsultimet publike me qytetarët; hartimi i anekseve të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit në fushën e mbrojtjes së mjedisit; organizimi i një takimi ekspertësh në bashkëpunim me Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit.

Projekti zgjat 12 muaj, dhe buxheti total i miratuar është 26,133.12 EUR.

Titulli i projektit: Për shëndet më të shëndetshëm!

Organizata udhëheqëse: Qendra e Monitorimit dhe Kërkimit (CeMI)

Partner: OJQ Bonum

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në shkallë më të madhe të barazisë në ushtrimin e së drejtës për kujdes shëndetësor në Mal të Zi.

Objektivat specifike janë përmirësimi i nivelit të mbrojtjes së të drejtave të pacientëve në sistemin e kujdesit shëndetësor të Malit të Zi; dhe uljen e nivelit të korrupsionit në sistemin shëndetësor, duke ngritur nivelin e ndërgjegjësimit dhe informimit të qytetarëve për dëmet dhe pasojat e korrupsionit në sistemin shëndetësor.

Rezultatet e pritshme janë: sistemi i analizuar i shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtja e të drejtave të pacientëve; zhvillimi i propozimeve për model dhe politika alternative për përmirësimin e punës së institucioneve shëndetësore dhe mbrojtjen e të drejtave të pacientëve; ndërgjegjësimi i rritur i qytetarëve për të drejtat e tyre si pacientë, me vëmendje të veçantë kundër diskriminimit, mbrojtjes së dinjitetit dhe privatësisë personale dhe të drejtës për akses të barabartë në kujdesin shëndetësor.

Në këtë drejtim, *aktivitetet* përfshijnë: kryerjen e hulumtimeve për politikat publike dhe aktet ligjore dhe të tjera në fushën e kujdesit shëndetësor; analiza e procedurave për emërimet/gradimet dhe punësime në sektorin e shëndetësisë, veçanërisht në lidhje me konfliktin e interesit, përkatësinë partiake/kombëtare/fetare dhe abuzimin; analiza e punës së menaxhmentit dhe mbrojtjes në institucionet shëndetësore; sondazhi i opinionit publik mbi nivelin e besimit të qytetarëve në sistemin e kujdesit shëndetësor të Malit të Zi dhe çështje të tjera të ndërlidhura në fushën e të drejtave të pacientëve dhe kujdesit shëndetësor; hulumtim cilësor për nivelin e mbrojtjes së të drejtave të pacientëve, korrupsionin dhe probleme të tjera shëndetësore; përgatitja e studimit të politikave publike në fushën e shëndetësisë, me rekomandime për përmirësimin e politikave dhe procedurave në fushën e të drejtave të pacientëve, antikorrupsion; fushatë avokuese për miratimin e politikave dhe procedurave të propozuara shëndetësore; fushatë për të rritur njohuritë e qytetarëve për të drejtat e tyre si pacientë, përmes mediave dhe rrjeteve sociale; përmirësimi i aplikacionit ekzistues celular dhe ueb të CeMI-t për kujdes të shëndetshëm shëndetësor, përmes të cilit qytetarët mund të raportojnë në mënyrë anonime dhe lehtësisht të gjitha rastet e mundshme të korrupsionit në sistemin e kujdesit shëndetësor; fushatë për të motivuar qytetarët malazezë që të raportojnë rastet e korrupsionit të mundshëm në kujdesin shëndetësor dhe shkeljet e mundshme të të drejtave të pacientëve përmes aplikacionit ose drejtpërdrejt tek autoritetet kompetente; dërgimin e raporteve për rastet e mundshme të korrupsionit dhe abuzimeve të tjera në shëndetësi pranë organeve kompetente, bazuar në raportimet e qytetarëve.

Projekti zgjat 12 muaj dhe buxheti total i miratuar është 47,679.00 EUR.



Titulli i projektit: **ZHUKA - Rrjeti i Kulturës së OSHC-ve në Tivar**

Organizata udhëheqëse: **OJQ Gradionica**

Partnerët: OJQ DES Scena, OJQ Portret, OJQ Qendra Arsimore

Bashkëpunëtorët: OJQ Pristan, OJQ Pogon

Objekti i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i zhvillimit në fushën e kulturës së OSHC-ve në qytetin e Tivarit.

Objekti specifik është rrjeti i organizatave kulturore të Tivarit “Zhuka”, si platformë për ngritjen afatgjatë të kapaciteteve të OSHC-ve lokale për bashkëpunim të ndërsjellë, si dhe bashkëpunim me institucionet vendore.

Rezultatet e pritura janë: formimi i rrjetit të organizatave kulturore Bar - Zhuka; fuqizimi i kapaciteteve të skenës dhe rrjetit lokal të OSHC-ve përmes trajnimeve të organizuara dhe vizitave studimore; përmirësimi i bashkëpunimit të OSHC-ve me Komunën e Tivarit përmes bashkëpunimit me institucionin kulturor të NP-së Qendra Kulturore Tivar.

Aktivitetet kryesore të planifikuara janë: formimi i rrjetit të organizatave kulturore; ngritja e kapaciteteve të OSHC-ve lokale përmes trajnimit për shkrimin dhe menaxhimin e projekteve; rrjetëzimi me rrjete të ngjashme në rajon dhe BE përmes vizitave studimore dhe tryezave të rrumbullakëta për tema specifike me rëndësi lokale në fushën e kulturës; organizimi i fokus grupeve dhe analiza e të dhënave të marra; përgatitja e bazës për strategjinë e ardhshme për kulturën në bashkëpunim me JPKC Tivar dhe Komunën e Tivarit.

Projekti zgjat 12 muaj, dhe buxheti total i miratuar është 42,832.94 EUR.

